



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Arsim, mbajtur më 12.10.2022, me fillim në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Dervishi, Lindita Rexhepi, Ajet Brajshori, Berna Saraçi, Gjylbehare Llapi.

Në mbledhje mori pjesë edhe: Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatmir Dervishi, kryesuesi i komitetit me këtë

## R E N D T Ë D I T Ë S

1. Miratimi dhe shqyrtimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Arsim;
2. Situata në arsimin para universitar në Komunën e Prishtinës (infrastruktura në shkolla, ankesat shkollore, siguria, mjetet e konkretizimit, digjitalizimi etj.);
3. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi dhe shqyrtimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Arsim

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Komitetit për Arsim.

Pika e dytë

Situata në arsimin para universitar në Komunën e Prishtinës (infrastruktura në shkolla, ankesat shkollore, siguria, mjetet e konkretizimit, digjitalizimi etj).

Besianë Musmurati, drejtore tha se me marrjen e mandatit, e kam parë se temë kyçe që duhet të trajtohet gjithqysh është siguria në shkolla, për shkak që me mbylljen gjatë pandemisë e kemi parë

edhe me raportet e policisë që dhuna në shkolla është rritur dhe kjo ka ndikuar që me pasur raste më shumë qoftë të dhunës fizike, qoftë të bullëzimit, qoftë online, ku pa e menduar fillimisht kemi me u marrë me këtë temë, pasi është temë shumë me rëndësi që s'mundemi me injoruar.

Kemi filluar me themelimin e komisionit i cili po merret tash me krijimin e planit strategjik të veprimit për sigurinë në shkolla, bashkë me Policinë e Kosovës, me OSBE-në, me Universitetin e Prishtinës, Departamentin e Psikologjisë, Departamentin e Edukimit, si dhe me organizata të ndryshme, si p.sh. The Children, Këshilli Rinor, këshilli i nxënësve, këshilli i prindërve dhe ekspertë të ndryshëm të fushës së arsimit që janë përfshirë në draftimin e këtij plani.

Takimet e grupeve punuese i kemi mbajt gjatë verës, tash po presim me ardhur me një finalizim të raportit të cilin mandej e publikojmë.

Ajo në vazhdim tha se, me që ende nuk është caktuar përfundimisht, por ka me i pasur 4 (katër) shtylla kryesore, e ato janë;

- infrastruktura fizike nëpër shkolla, kemi me i rinovuar fizikisht shkollat që ato me qenë më të sigurt;
- çka kemi me bërë në nivel të menaxhimit të shkollave sa i përket dhunës dhe parandalimit të dhunës;
- bashkëpunimet me sektor të tjerë, qoftë të Komunës, qoftë të Ministrisë së Arsimit që nismat ligjore me qenë në vijë me politikat që ne duam me i hartuar.
- është menduar që me e angazhuar mirëqenien si temë well being, është anglisht se nuk dinim si me e përkthyer mirë në shqip dhe me u fokusuar më shumë tek parandalimi i dhunës se sa tek trajtimi i dhunës, ku secila shtyllë ka me i pasur aktivitetet dhe nën aktivitetet, si dhe kemi me tentuar që me e buxhetuar secilën.

Ne kemi punuar edhe në buxhetin për vitin e ardhshëm i cili është aprovuar edhe në asamble, buxheti ka pasur komponentë historike, por ka edhe risi shumë të mëdha.

Ajo mes tjerash tha se në takimin që ka pasur me UNICEF-in, e cila për herë të parë ka pranuar të merr Komunën e Prishtinës nën ombrellën e komunave që ajo i mbulon, pasi që ka shumë projekte që ndërlihen me sigurinë e fëmijëve.

Ajo në vazhdim tha se pjesë kryesore është edhe pjesa e rekrutimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, pasi që pjesa e madhe e drejtorëve të cilët janë përzgjedhur viteve të kaluara inspektorati i arsimit i ka cilësuar si jo ligjore për shkak të procedurave në rekrutim.

Zyra ligjore e ka dërguar opinion ligjor që ne duhet me i rishpallur ato pozita ku dhe jemi në procesin e dizajnit të konkurseve të tjera, ku procesin e dizajnit e kemi bërë së bashku me Ambasadën Britanike, ku dhe kemi me vendos standard sa i përket dokumentacionit të drejtorëve për të ju ndihmuar që nga shpallja e konkursit e deri tek fazat e aplikimit.

Si pjesë tjera kryesore ajo cekti edhe shpalljen e 25 vende të reja pune për psikolog, pasi që shëndetin mendor e kemi si prioritet që hynë në temën e sigurisë në shkolla. Pastaj është digjitalizimi i procesit dhe zhvillimi i një softueri i cili ka me ju mundësuar fëmijëve komunikimin në kohën reale me arsimtarin, arsimtarin me prindin apo drejtorin.

Ndërsa lidhur me projektet e çerdheve dhe renovimin e shkollave tha se projekti pasi që ka qenë i bllokuar është fituar në gusht, mirëpo shpresojmë se përmes zyrës së arkitektit të cilën e ka propozuar kryetari, çështjen e projekteve do të e kemi më lehtë.

**Gjylbehare Llapi**, shtroi pyetje se kur pritet me filluar punën Zyra e arkitektit.

**Besianë Musmurati**, drejtores lidhur me pyetjen e znj. Llapi tha se nuk është në dijeni se kur do të fillon, por kurdo që të fillon mendoj dhe shpresoj se do të na ndihmoj shumë në këtë aspekt. Pasi që kemi shumë organizata të cilat vijjnë dhe na thonë që ne të ua sigurojmë tokën dhe projektet kurse ata të financojnë.

Prandaj mendoj se Komuna e Prishtinës duhet me pas kapacitet për me e gjetur tokën dhe projektin që ata vetëm me filluar me punën.

Ajo mes tjerash tha se jemi duke punuar për me i rritur kapacitetet edhe të DKA-së, ku dhe i kemi marrë dy zyrtar nga investimet kapitale të cilët janë arkitekt të ndërtimitarisë që i kemi vendosur si staf tek që të merren me këto projekte të investimeve kapitale.

**Fatmir Dervishi**, lidhur me çështjen e 25 psikologëve tha se dua të kërkoj nga Ministria e Arsimit dhe e Financave, që të na i lejojnë edhe 25 psikologë ku besoj se do të ishte përmbyllur mirë numri 50 i psikologëve, sepse kjo është për të mirën e fëmijëve tanë dhe të gjithë qytetarëve. Ndërsa çështja tjetër është se dua të ndalem tek çështja e drejtorëve se nuk munda ta kuptoj se a kanë me qenë pyetjet e njëjta për drejtorë të shkollave të mesme, shkollave fillore dhe për çerdhe.

**Besianë Musmurati**, drejtores lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Dervishi tha se pyetjet do të jenë të njëjta brenda kategorisë, ku pyetjet do t'i kenë në WEB faqen e Komunës.

**Fatmir Dervishi**, duke iu drejtuar drejtores së arsimit tha se tek pika katër është cekur mirëqenia sociale, mendoj se po që se punësohen këta 50 psikologë në të gjitha shkollat e Prishtinës, ku diku i kemi 70 sosh duhet shikuar secila shkollë sa nxënës ka e me i caktuar se për sa psikolog ka nevojë shkolla. Shkolla fillore "Ismail Qemali", ka 2000-3000 nxënës një psikolog është pak por duhet shtuar numrin e tyre.

Ai në vazhdim cekti edhe problemin e zëvendësimit të orëve dhe mungesën e mësimdhënësve, ku disa prej tyre shkojnë në pushim të lehonisë, e disa shkojnë për 2-3 ditë në raste sëmundjeve gripoze etj, ku me të vërtet kemi probleme, prandaj këtë çështje duhet ta diskutojmë.

Kisha me propozuar që ne si komitet të diskutojmë dhe të bëjmë një plan meqë e di se ka pengesa por të bëjmë një plan dhe të dërgojmë një kërkesë tek Ministria e Arsimit dhe Financave, që të na mundësojnë buxhetin për këtë kategori, pasi që vërtet është shqetësuese.

**Lulzim Vrapca**, lidhur me çështjen e 25 psikologëve tha se me të vërtet më vjen keq që çështjet e tilla që janë të rëndësishme për kryeqytetin pra për Prishtinën shndërrohen në çështje kauze. Ai në vazhdim tha se është bërë një planifikim shumë i mirë brenda programeve realisht sa i përket plotësimit të fondit tonë dhe plotësimit të normave mësimore. Realisht kjo punë ka filluar prej muajit mars, prill ku dhe e kemi themeluar komisionin i cili është marrë me ata që kanë nga 14 orë. Është dashur me i gjetur edhe 6 orë dhe me e bërë një kombinim ku një mësimdhënës ka shkuar në 2-3 shkolla dhe kemi arritur deri në këtë pikë. Ndërsa sa i përket zëvendësimit të orëve tha se vërtetë kemi një praktikë si shoqëri por edhe si individ jemi të prirë që të përfitojmë nga benefitet.

**Besianë Musmurati**, drejtore duke i drejtuar të pranishmëve tha se ajo çka është e rëndësishme është se Komuna e Prishtinës e ka një limit të punëtorëve në arsim i cili nuk mundet me u tejkaluar çdo vit, ku limiti për Komunën e Prishtinës është diku 3100 të punësuar për t'i mbuluar orët ekzistuese për fëmijët ekzistues, ku në këtë numër përveç mësimdhënësve hynë edhe punëtorët teknik, asistentët e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Ajo në vazhdim tha se sa i përket rritjes së numrit të limitit tha se për me e rritur limitin për 50-60 vende pune ne kemi me mbërri me e përthekuar edhe për punëtorët teknik për të cilët kemi nevojë. Ajo tha se kemi shumë tema të cilat sa i përket çështjes së numrave me të vërtet na duhet një mbështetje pak më e madhe sa i përket bashkëpunimit me Qeverinë, pasi që me të vërtet kemi nevojë për me i shtuar numrat e punëtorëve.

Ajo mes tjerash tha se në takimin që ka pasur me zëvendës ministrin ndër shumë tema që kanë për tu biseduar kemi biseduar edhe për çështjen e digjitalizimit, pasi që digjitalizimi i shkollave është shumë i nevojshëm.

**Berna Saraçi**, lidhur me 66 pozitat për pedagog dhe psikolog tha se ministrja e Ministrisë së Arsimit ka shkruar se janë 66 pedagog dhe psikolog, kurse ju po thoni se nuk ekzistojnë por janë vetëm dhjetë vende të lira këtë nuk po e kuptoj.

**Besiana Musmurati**, drejtore lidhur me diskutimin e znj. Saraçi tha se siç thash edhe më herët se si ekzistojnë 3100 vende pune pasi që këtu hynë punëtorët teknik dhe asistentët e fëmijëve me nevoja të veçanta.

**Lulzim Vrapca**, tha se duke u nisur nga përvoja ime dhjetë vjeçare në Sektorin e burime njerëzore në Komunën e Prishtinës edhe ne si burime njerëzore të Drejtorisë së Arsimit, çdo herë kanë qenë në numra mbi limit. Një prej arsyeve është që mësimi zgjedhor, drejtorët nëpër shkolla e kanë bërë rekrutimin e mësimi zgjedhor. Prishtina për herë të parë e ka bërë një konkurs për mësim zgjedhor tash. Kanë qenë norma shumë më shumë se sa që ne e kemi shpallur konkursin për 27 (njëzet e shtatë) vende, mirëpo keq kjo ka qenë, kur ju është bërë kontrata disave edhe me 10 (dhjetë) orë. Ai në vazhdim tha se si besoj që i kemi qëndrua asaj, jena munduar çdo kund, pushimet pa pagesë në njërën anë, pastaj tek plotësimi i normave, tek mësimi zgjedhor dhe kemi arritur tek ky numër ku jemi këtu.

**Besianë Musmurati**, drejtore duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Vrapca tha se ne jemi munduar në maksimum me e racionalizuar shfrytëzimin e resurseve që i kemi në maksimum. Po e përsëris i kemi larguar kontratat sekondare, jemi munduar çdo send me e "shtrydh" nga pak që me i nxjerrë disa numra, por këta numra nuk mjaftojnë me i zgjidh problemet që i kemi. Ka mjaftuar për psikolog, por nuk ka mjaftuar për pedagog, për punëtorë teknik, për mësimdhënës dhe për zëvendësime etj.

**Ajet Brajshori**, tha se duke u ndërlidhur me diskutimet duke mos i përsëritur ato që u than deri me tani dua ti nxjerr disa çështje edhe nga ana ligjore, nga ana profesionale. Ai në vazhdim tha se për të qenë një shkollë me mbarëvajtje të procesit mësimor në mënyrën më të rregullt duhet të fuqizohen organet profesionale dhe qeverisjen në shkolla.

Kot punojmë ne këtu nëse në shkollë nuk i kemi organet funksionale, siç janë drejtori i shkollës, Këshilli drejtues i shkollës, Këshilli i arsimtarëve e kështu me radhë. Prandaj bëj thirrje drejtores, normalisht që ju e shfrytëzoni kapacitetin që e keni dhe e di që jeni në minus edhe në drejtori komunale e tha edhe shefi, ne i dimë edhe kapacitetet e gjithë stafit që i keni aty, por t'i fuqizoni edhe organet për aq sa mundeni edhe aty për t'i futur në funksion organet profesionale në shkollë. Nëse ato janë në nivelin e detyrave këto se çka do t'i përmendi më vonë do t'i kemi në mënyrën më të mire dhe ndoshta nuk do të kemi nevojë për investime shtesë, ku është fjala për siguri edhe këtu.

Ai mes tjerash tha se përveç këtyre vinë edhe bashkëpunëtorët profesional, që jemi larg prej standardeve të botës. Bashkëpunëtorë profesional është psikologu, pedagogu, sociologu, mjeku, e këto janë standardet bashkëkohore edhe pse e dimë që jemi larg. Folëm edhe për psikolog, ky numri 25 nuk e di a është marrë në numrin e indeksit të numrit të nxënësve në përgjithësi, sepse është me udhëzim administrativ se një psikolog sa nxënës mundet me i trajtua.

Tani me marr një psikolog për viset rurale, ku të gjitha shkollat në viset rurale nuk i bëjnë 1000 (një mijë) nxënës, bile as 200. Është një problem në vete, duhet bërë një analizë e brendshme se çka duhet bërë, e jo me i anashkalua ata, sepse edhe ata kanë nevojë për një psikolog.

Ai në vazhdim tha se nuk e di se a keni bërë ndonjë analizë, mirëpo unë po ju jap si ide se duhet të bëhet kjo analizë, pasi që nëse nuk gaboj në Kosovë i kemi 5176 nxënës më pak, vendi i dytë ku nxënësit kanë bërë migrim më së shumti, sigurisht e ka goditur edhe Prishtinën.

**Besianë Musmurati**, drejtore tha se nga e gjithë kjo që u fol deri më tani nga të gjithë ju kisha preferuar që me mendua për punën dhe me u profilizua secili prej juve në temat që do të diskutohen në mbledhjet e këtij komitetit pasi që ka shumë tema.

Ajo në vazhdim tha se kur ju jeni të profilizuar në temat përkatëse atëherë në mundemi të ju ftojme kudo që kemi aktivitete lidhur me temat, pasi që ne përgjatë gjithë kohës kemi aktivitete dhe kemi nevojë për mbështetje sekondare.

*Mbledhja mbaroi në orën 18:00*

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

Kryesuesi i komitetit  
Fatmir Dervishi

